



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 82/
5 prot.

Tiranë, më 18.01.2022

VENDIM QARKULLUES

Nr. 2 , datë 18.01.2022

PËR

**“PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË GRANTIT TË MËSIMDHËNIES, PËR
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN 2022”**

Në bazë të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Statutit të UMT-së, VKM-së nr.75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit të përbashkët nr.20, datë 20.09.2019 “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor” të Ministrisë të MFE-së dhe Ministrisë të MAS-së, Vendimit Qarkullues të Senatit Akademik nr. 1, datë 17.01.2022 “Për miratimin e Shpërndarjes së Grantit...”, pasi mori në shqyrtim materialin e Administratores së UMT-së me nr.82/4 prot., datë 18.01.2022 “Relacion shpjegues për ndarjen e grantit buxhetor, për vitin 2022”, Bordi Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë shpërndarjen e grantit vjetor të mësimdhënies, i detajuar për paga, sigurime, mallra materiale dhe bursa për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin 2022.
2. Granti i detajuar do të shpërndahet sipas tabelave, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet Sektori i Koordinimit Institucional, për publikimin e tij në faqjen zyrtare të internetit të UMT-së.

**KRYETAR
ZAMIRA GJINI**

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ